



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E FINANCËS DHE BUXHETIT

PROJEKTVENDIM

Nr 16272 Datë 19.08. 2026

Për një shtesë dhe ndryshim në VKB nr.113, datë 15.12.2025 “Për miratimin e PBA-së 2026-2028 dhe Buxhetit Vjetor 2026”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; të VKM nr.479, datë 26.06.2026 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit të njësive individuale të banimit në bashkitë Kurbin dhe Lezhë”; të Udhëzimit Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”; dhe të shkresës Ministrit të Financave nr.10819/2, datë 16.07.2026 “Mbi zbatimin e VKM-së nr.479, datë 26.06.2026”, Kryetari i Bashkisë paraqet projektin përkatës, Këshillit të Bashkisë;

Për të vendosur :

- Miratimin e një shtese në Buxhetin e Bashkisë për vitin 2026 në:
 - Gr.00, Prog.04960, Kap.1 Art.604 në shumën 297,250,000 lekë. Kodi i Projektit 94902AB.
- Miratimin e përdorimit të fondit të akorduar si më poshtë:

Nr	Programi	Projekti	Kap.	Art.	Shuma lekë	Emërtimi
1	06140	94902AB	01	606	297,250,000	Rikonstruksion/riparim i banesave individuale, i mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta dhe njësive të banimit

- Për zbatimin e vendimit ngakohen: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimi Urban & Drejtoria Juridike.
- Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55, pika 6, e ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

KRYETARI

Pjerin Ndreu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E FINANCËS DHE BUXHETIT

Nr. 16272/1 Prot

Lezhë, më 18.08.2026

RELACION

**LIDHUR ME PROJEKTVENDIMIN E PARAQITUR PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË
AKORDUAR PËR RINDËRTIMIN/RIPARIMIN E BANESAVE INDIVIDUALE, I
MJEDISEVE NË BASHKËPRONËSI OSE TË PËRBASHKËTA DHE NJËSIVE TË BANIMIT
TË DËMTUARA NGA TERMETI I VITIT 2019**

Të nderuar këshilltarë,

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; i ndryshuar; të VKM nr.479, datë 26.06.2026 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit të njësive individuale të banimit në bashkitë Kurbin dhe Lezhë”; të Udhëzimit Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”; dhe të shkresës së Ministrisë Financave nr.10819/2, datë 16.07.2026 “Mbi zbatimin e VKM-së nr.479, datë 26.06.2026”, relatoj si më poshtë:

- Fondi i i akorduar nga Buxheti i Shtetit është në shumën 297,250,000 lekë, i cili do të përdoret për mbështetje financiare të 783 familjeve, për rikonstruksionin/riparimin e banesave individuale, i mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta dhe njësive të banimit.
- Kërkesa dhe relacioni shpjegues më i detajuar është paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban.

Prandaj, ju propozoj miratimin e përdorimit të fondit të akorduar nga Buxheti i Shtetit për familjet përfituese, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga shkaqet natyrore (termeti).

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETARI

Pjerin Ndreu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TE TERRITORIT DHE ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 16180 Prot.

Lezhë më 18.08.2026

MIRATOHET
KRYETARI
Pjerin NDREU



Lënda: Kërkesë për miratimin e përdorimit të fondit të rindërtimit.

DREJTORISË SË FINANCËS DHE BUXHETIT ✓

KËTU

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të VKM nr. 479, datë 26.06.2026 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit të njësive individuale të banimit në Bashkitë Kurbin dhe Lezhë”, referuar shkresës me Nr.10819/2 Prot., datë 16.07.2026 nga Ministria e Financës për zbatimin e Vendimit të Këshillit të ministrave me nr.479, datë 26.06.2026 të Udhëzimit Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, kërkoj nga ana juaj që:

Të na mundësoni alokimin e përdorimit të fondit nga buxheti i shtetit për financimin e rikonstruksionit të njësive individuale të banimit në shumën 297,250,000 lekë për 783 banesave të dëmtuara nga tërmeti me shkallë ndërtimi DS1, DS2 dhe DS3.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

DREJTORI
Flamur Kuçi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TE TERRITORIT DHE ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 16180/ Prot.

Lezhë më, 18.08.2026

Lënda: Relacion shpjegues për miratimin dhe përdorimin e fondit të rindërtimit.

DREJTORISË SË FINANCËS DHE BUXHETIT

KËTU

Bazuar në ligjin nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", Vendimit nr. 750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave "Pë shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë", i ndryshuar, Aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019 të Këshillit të Ministrave "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", Vendimin e nr. 904, datë 24.12.2019 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit", Vendimit nr. 5, datë 06.01.2020 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projekti model", Vendimit nr. 479, datë 26.06.2026 të Këshillit të Ministrave "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit të njësive individuale të banimit në Bashkitë Kurbin dhe Lezhë":

Bashkisë Lezhë i akordohet fondi, në masën 297,250,000.0 lekë pa TVSH. VKB nr.76, datë 09.06.2020 "Për miratimin e masës së grantit të rikonstruksionit ose riparimit për nivelin e dëmit DS1, DS2, DS3, për banesat e dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019 në Bashkinë Lezhë", VKB nr. 26, datë 23.03.2022 "Për miratimin e listave të përfituesve për grante rikonstruksioni për shtëpitë individuale dhe banesa në ndërtesa (pallate) me shkallë dëmtimi DS1, DS2, DS3", dhe VKB nr.77, datë 06.07.2022 "Për miratimin e listës së subjekteve ankues, për kategorinë DS1, DS2 dhe DS3 të cilëve iu është pranuar ankesa nga komisioni i ankimit".

Në total janë 783 familje të shpallur përfitues të grantit të rikonstruksionit ose riparimit sipas shkallës së dëmtimit të vlerësuar nga inxhinierët.

Niveli i dëmit	Numri i Subjekteve Përfituese	Masa e Grantit e shprehur në lekë	Vlera totale e shprehur në lekë
DS1	120	100,000	12,000,000
DS2	185	250,000	46,250,000
DS3	478	500,000	239,000,000
TOTALI	783		297,250,000

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

DREJTORI
Flamur Kuçi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E FINANCËVE VENDORE

Nr. 10819/2 prot.

Tiranë, më 16 7 2026

Lënda: Mbi zbatimin e VKM-së nr.479, datë 26.06.2026

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË THESARIT

BASHKISË Lezhë

DEGËS SË THESARIT _____

Për dijeni: **MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**

Në zbatim të ligjit nr. 87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026", të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", të Vendimit nr.479 datë 26.06.2026 të Këshillit të Ministrave "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit të njësive individuale të banimit në bashkitë Kurbin dhe Lezhë", miratojmë detajimin e fondit për financimin e rikonstruksionit të njësive individuale të banimit, për bashkitë Kurbin dhe Lezhë, sipas tabelës bashkëlidhur.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

MINISTRI

Petrit Malaj



Ent.Qev	Gr.	Kod.Institucioni	Kap.	Programi	Llogaria ekonomike	Kodi i Qarkut (Dega Thesarit)	Projekti	Vlera (në lekë)
SHTOHET								
001	99	0000000	01	04960	6040000	3535	90005AA	327,350,000
PAKËSOHET								
001	49	1049001	01	04920	6090000	3535	94902AA	327,350,000